



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1486 Prot.

Lezhë, më 04.02. 2022

VENDIM

Nr. 10 Datë 01.02.2022

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE TË AKTIVITETEVE TEMATIKE  
KULTURORE-ARTISTIKE DHE TURISTIKE**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, Neni 54 pika k, në Ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, kreu VI “Institucionet publike vendore të artit dhe të kulturës “ neni 29 “Burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit dhe kultures” pika a b, c, ç, d, dh, si dhe në vendimin nr. 177 date 23. 12. 2021 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe programit buxhetor afatmesem 2022-2024” të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

- Miratimin e shpërblimit të artistëve, moderatorëve, kulturologëve, historianëve, studiuesve, shkrimtarëve dhe poetëve, që do të marrin pjesë në realizimin e eventeve dhe veprimtarive artistike, kulturore dhe turistike të propozuara dhe të miratuara nga Bashkia Lezhë dhe Këshilli Artistiko-Kulturor dhe Turistik, si më poshtë:
  - Shpërblim maksimal nga 100 - 150 mijë lekë. Këto shpërblime janë për artistë me rëndësi kombëtare për aktivitetet që Bashkia Lezhë u jep një rëndësi të kësaj forme. Shpërblime të çmimeve të para të konkurseve me rëndësi kombëtare.
  - Shpërblim mesatar 50-100 mijë lekë. Këto shpërblime janë për anëtarë jurie konkurses, fituesit e çmimeve, artistët në nivel kombëtar dhe lokal në konkurse letrare, artistike, kulturore.
  - Shpërblim minimal 5-50 mijë lekë. Këto shpërblime janë për moderatorë, artistë, instrumentistë, recitues, akademikë dhe studiues për aktivitete me rëndësi lokale.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Turizimit dhe Kulturës.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

